



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT LUMOR ISHËM

VENDIM

Nr.13, datë 22/12/2025

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR RINOVIM TË LEJES/AUTORIZIMIT,
LIDHUR ME RINOVIMIN E LEJES NR. SERIE 00005 SERIAL,
MIRATUAR ME VENDIMIN NR.6, DATË 27.02.2020, “LEJE PËR
PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR”, TË SUBJEKTIT
“TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT”

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore” i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.319, datë 11.06.2025, *“Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujqor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”,* me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovim të lejes/autorizimit, lidhur me rinovimin e lejes Nr.00005 serial “Leje për përdorim burimi ujqor nëntokësor”, miratuar me Vendim Nr.6 datë 27.02.2020, të subjektit “Tirana International Airport”, me vendndodhje: Njësia Administrative Fushë Krujë, Bashkia Krujë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Koordinatat e vendndodhjes së pus-shpimit:

X= 476175.4; Y= 4586968.6; Z= 35.7 m; (KRGJSH)

Lloji i aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji: Për qëllime teknologjike.(MNZ)

Sasia e ujit që jepet në përdorim: $Q = 4 \text{ l/sek}$

Volumi i shkarkimit të ujrave të përdorura: $Q = 1 \text{ l/sek}$

Vendi i shkarkimit të ujrave të përdorura: Lumi i Tërkuzës (pas trajtimit në impiant)

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBL ISHËM

EMILJAN JANI

